



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 4242/prot.

Himarë, më 16.06.2025

URDHËR

Nr. 352 Datë 16.06/2025

PËR

**DISA SHTESA DHE NRYSHIME NË URDHRIN NR.334. DATË 09/06/2025
“PËR DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMEVE GJATË SEZONIT
TURISTIK”**

Mbështetur në ligjin Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin Nr. 139/ 2015 datë 17.02.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ligjin 9780/2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, ligjin 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjin 93/2015 “Për turizmin”, VKM Nr.894/2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, dhe VKB Himarë Nr.7 datë 11.02.2025 “Për miratimin e planit të punës, për menaxhimin e sukseshëm të sezonit turistik 2025 dhe planit të veprimit përkatës” me qëllim sigurimin e një sezoni të qëndrueshëm , krijimin e një mjedisi miqësor për pushuesit vendas dhe të huaj, duke eliminuar ndotjet dhe zhurmat që vijnë si rezultat i ndërtimeve:

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.334 datë 09/06/2025 “Për disiplinimin e punimeve të ndërtimeve gjatë sezonit turistik”, të bëhet ky ndryshim:

Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

- 1- Pezullimin e përkohshëm të punimeve, të subjekteve që janë pajisur me leje ndërtimi nga Bashkia Himarë në zonën e Njësisë Administrative Himarë dhe Njësisë Administrative Lukovë, për periudhën 15.06.2025-15.09.2025.

Në pikën 1 të urdhrit shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

1/1- Të ndalohet për periudhën 16/06/2025 deri më 15/09/2025, qarkullimi i mjeteve rrugore të rënda që shërbejnë për transportin e materialeve të ndërtimit (auto betoniere, autovinça, eskavatorë, kamionë etj) në segmentet rrugore të Njësisë Administrative Himarë dhe Njësisë Administrative Lukovë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Vangjel Lavo

